



DEKLARATA VJETORE E TË ARDHURAVE PERSONALE

Afati i dorëzimit: 30 prill 2020



Me afrimin e afatit për dorëzimin e Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale, dëshirojmë t'ju kujtojmë lidhur me detyrimet dhe modalitetet e dorëzimit të Deklaratës.

Çfarë është?

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale, është një formular që individët dorëzojnë pranë autoriteteve tatimore Shqiptare, me qëllim raportimin e të ardhurave të gjeneruara përgjatë vitit, si dhe llogaritjen dhe pagesën e tatimit përkatës.

Afati për dorëzimin e Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale për vitin fiskal 2019, është 30 Prill 2020.

Kush preket?

Bazuar në Ligjin Nr. 8438 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", datë 28.12.1998, individët rezidentë dhe jo-rezidentë, që realizojnë të ardhura vjetore bruto mbi 2 milionë lekë, janë të detyruar të plotësojnë dhe të dorëzojnë Deklaratën Vjetore të të Ardhurave Personale. Për rezidentët Shqiptarë, kufiri prej 2 milionë lekë, aplikohet për të ardhurat e realizuara brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, ndërkohë për individët jo-rezidentë, kufiri është i aplikueshëm vetëm për të ardhurat e gjeneruara në Republikën e Shqipërisë.

Në koherencë me nenin 8 të ligjit të sipërpërmendur, konsiderohet si e ardhur: paga dhe shpërblimet lidhur me punësimin, dividendët, interesat, e drejta e autorit, të ardhurat nga qeraja, të ardhurat nga lojërat e fatit dhe kazinotë, të ardhurat kapitale dhe lloje të tjera të të ardhurave jo të specifikuar në këtë nen.

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale mund të përgatitet dhe të dorëzohet vullnetarisht nga individ të cilët nuk përmbushin kushtin e vendosur për kufirin 2 milionë lekë, në rast se ata duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e aplikueshme për disa kategori specifike të të ardhurave.

Si mund të përmbush detyrimin për dorëzim?

Dorëzimi i Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave, kryhet elektronikisht nëpërmjet sistemit të tatimeve ([eFiling](#)).

Individët të cilët aktualisht kanë një llogari aktive në faqen e përmendur, mund të aksesojnë nëpërmjet saj dhe të plotësojnë elektronikisht formularin për vitin fiskal 2019.

Individët të cilët nuk kanë një llogari aktive, duhet:

- ***Për individët Shqiptar-*** të regjistrohen në sistemin eFiling (sistemi i tatimeve) dhe krijojnë një adresë nëpërmjet plotësimit të të dhënave personale të kërkuara dhe vendosjes së një password-i.
- ***Për individët e huaj-*** personalisht/ ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, duhet të paraqiten te Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të pajisen me një password, i cili do t'i japi mundësinë individit të aksesojë sistemin e tatimeve.

Pas aktivizimit të llogarisë, individët duhet të plotësojnë elektronikisht formularin e kërkuar për vitin fiskal 2019.

Çfarë ndodh në rast mospërmbushje të detyrimit për dorëzim?

Në rast mosdorëzimi të Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale, individit i aplikohet një gjobe prej 5,000 lekësh.

Individët të cilët kanë dorëzuar Deklaratën Individuale të të Ardhurave Personale në përputhje me afatin e përcaktuar, mund ta ndryshojnë atë deri në dy herë brenda 3 muajve nga dorëzimi i pare pa penalizim. Korrigjimet e deklaratës pas herës së dytë, do t'i nënshtrohen penaliteteve përkatëse, në rast se ndryshimet rezultojnë në detyrim tatimor shtesë.

Për më shumë detaje për sa më sipër ose lidhur me çështje të tjera në lëmin fiskal, ju lutem referohuni tek:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al